

PRISHTINA



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
OPŠTINA PRISTINA - MUNICIPALITY OF PRISTINA

# **PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E SHËRBIMEVE DREJTORIA PËR KADASTËR DHE PRONË**

**PRILL 2024**



*Ky dokument është realizuar me mbështetje nga popullit amerikan përmes Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Tetra Tech/ARD dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.*

## HYRJJE

Me mbështetjen e Aktivitetit të USAID-it Qeverisja e Pronës (PGA), në komunën e Prishtinës përkatësisht në Drejtorinë për Kadastër dhe Pronë (DKP) është realizuar një vlerësim i proceseve aktuale të ofrimit të shërbimeve, është dokumentuar koha e nevojshme për ofrimin e shërbimeve, janë vlerësuar kapacitetet njerëzore dhe institucionale për qasje dhe mirëmbajtje konsistente të të dhënave sipas modelit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe Sistemit të Informacioneve Kadastrale për Tokën në Kosovë (SIKTK), janë identifikuar opsionet për të bërë automatizimin e shërbimeve dhe përmirësuar qasjen e qytetarëve në këto shërbime si dhe ka analizuar kornizën rregulluese të drejtave pronësore, procedurave dhe praktikave, me qëllim që të identifikohen dhe dokumentohen mospërputhjet ose devijimet *vis-à-vis* legjisllacionit në fuqi, përfshirë këtu edhe procedurat e ankimimit. Po ashtu në kuadër të vlerësimi është analizuar se a ka ndonjë sjellje diskriminuese e cila mund të pengoj gratë në qasje dhe në marrje të shërbimeve kadastrale efikase dhe të barabarta.

Me qëllim të adresimit të gjitha të gjeturave nga ky vlerësim, Komuna e Prishtinës me mbështetje nga AQP, ka realizuar një punëtori një ditore më 25 Prill 2024, me pjesëmarrje të gjerë nga të gjitha dikasteret e Komunës së Prishtinës dhe përfaqësues nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Punëtorja është mbajtur në 3 (tri) grupe tematike të punës: Grupi I-Gjeodezi dhe Kadastër, Grupi II–Pjesa Ligjore dhe Grupi III-Përfshirja Gjinore dhe Sociale.

Planin i Përmirësimit të Ofrimit të Shërbimeve përmban të gjeturat nga raportet e vlerësimit dhe ofron rekomandime konkrete për përmirësimin e kualitetit dhe rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve nga DKP. Ky dokument ka detajuar veprimet për zbatimin e rekomandimeve, duke identifikuar të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren, autoritetet përgjegjëse, ndikimet buxhetore, afatet kohore si dhe rreziqet dhe sfidat që do të afektonin në arritjen e qëllimeve të parapara në plan.

PGA në vazhdimësi do të asistojë Komunën e Prishtinës në mënyrë që rekomandimet nga ky plan, të konkretizohen me veprime konkrete, në të njëjtën kohë, ky plan do të mbikëqyret dhe raportohet për nivelin e zbatimit të tij nga DKP Prishtinë, Komiteti për Praktika të Mira dhe Forumi për Transparencë të Pronës.

## SHKURTESAT

<b>ABGJ</b>	Agjencia për Barazi Gjinore
<b>AKK</b>	Agjencia Kadastrale e Kosovës
<b>AQP</b>	Autoriteti Qendror i Prokurimit
<b>DAP</b>	Drejtoria e Administratës Publike
<b>DF</b>	Drejtoria e Financave
<b>KK</b>	Kuvendi Komunal
<b>LBGJ</b>	Ligji për Barazi Gjinore
<b>LK</b>	Ligji për Kadastër
<b>LPPA</b>	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
<b>MAPL</b>	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
<b>PGA</b>	Aktiviteti Qeverisja e Pronës
<b>RDPP</b>	Regjistri i të Drejtave të Pronës së Paluajtshme
<b>SIKTK</b>	Sistemi i Informacionit Kadastral për Tokat në Kosovë
<b>UA</b>	Udhëzim Administrativ
<b>ZBGJ</b>	Zyra për Barazi Gjinore

## PLANI PËR PËRMIRËSIMIN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE KADASTRALE - KOMUNA PRISHTINË

### PJESA GJEODEZI-KADASTËR dhe PJESA LIGJORE

Nr.	TË GJETURAT	Nr.	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	Ofrimi i shërbimeve dhe produkteve nga sporteli	1.1	Shtimi i resurseve njerëzore me 6 zyrtarë shtesë (3 zyrtar në sportel dhe 3 zyrtar për përpunim të lëndëve)	Kërkesa nga ZKK tek Zyra e Burimeve Njerëzore	ZKK dhe Zyra e personelit	6 x 630 = 3780 në muaj	Q4-2024	Mungesa e aplikimeve specifike nga sektori i gjeodetëve
		1.2	Trajnime për zyrtarët e ri të angazhuar	ZKK, AKK dhe PGA	AKK, ZKK dhe PGA	-	Q4-2024	Nëse nuk pranohen zyrtarë të ri
		1.3	POS në sportel apo sektori privat bankar (tek pjesa e sportelit të postës), si dhe të punohet prej 08:00-16:00	Kërkesa nga Komuna tek Operatorët Bankar	Komuna, Posta dhe Operatori Bankar	-	Q4-2024	Mos arritja e marrëveshjes mes Komunës dhe Postës apo operatorëve bankar
		1.4	Kualiteti i skanimit në sportel nuk është i kënaqshëm, duhet të sigurohet skaner me kualitet të lartë të skanimit	Kërkesë nga ZKK tek AKK dhe AQP	ZKK, AKK dhe AQP	-	Q3-2024	Papërgjegjësia e operatorit ekonomik
		1.5	Lista e dokumentacioneve për shërbime kadastrale duhet të jetë e publikuar, në mënyrë që qytetarët të kenë informata për dokumentacionin që nevojitet për lëndë të caktuar kadastrale.	Dizajnimi dhe Printimi i listave nga udhëzuesit e ri nga AKK	AKK, ZKK dhe PGA	1500	Q2 - 2024	Vonesa në hyrjen në fuqi të UA dhe përpilimin e Udhëzuesve të punës nga AKK
		1.6	Publikimi i listës së gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara	Printimi i listës së gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara	ZKK, AKK dhe PGA	-	Q2-2024	Sfidë mund të jetë mirëmbajtja e listës pasi që çdo 3 muaj është afati i aplikimit për licencim
		1.7	Në sportelet e ZKK-së duhet të ketë fletëpalosje informuese për produktet dhe shërbimet kadastrale.	Printimi i fletëpalosjeve dhe udhëzuesit e ri nga AKK	AKK, ZKK dhe PGA	1500	Q2 - 2024	Vonesa në hyrjen në fuqi të UA dhe përpilimin e Udhëzuesve të punës nga AKK
2	Zyra pritëse	2.1	Të diskutohet zbatimi i marrëveshjes i nënshkruar në mes të Komunës dhe Bankës Botërore me rastin e renovimit të hapësirave të Komunës	Takim me Drejtorinë e Administratës dhe rikthimi i hapësirave të destinuara për ZKK-në	ZKK, Drejtoria e Administratës dhe AKK	-	Q4-2024	Pamundësia e realizimit të marrëveshjes
		2.2	Sektori i kadastrit të shfrytëzojë sportelet ku dorëzohen lëndët e gjeodetëve dhe kompanive gjeodete të licencuara	Koordinim në mes të sektorëve brenda ZKK-së	ZKK	Nuk parashihen ndikime buxhetore	Q3-2024	Nuk parashihen rreziqe

3	Hapësira arkivore në ZKK është e kufizuar dhe e pamjaftueshme për të ruajtur numrin në rritje të dokumenteve në formë fizike.	3.1	Lirimi i hapësirës duke dërguar lëndët e vjetra të arkivuara në arkivën komunale që pritet të funksionalizohet tek objekti i Komunës	Kërkesa nga ZKK në Drejtorinë e Administratës	ZKK, Drejtoria e Administratës	-	Q4-2024	Mos funksionalizimi i arkivës tek Objekti i Komunës së re
4	Mungesa e resurseve njerëzore	4.1	Sektorit të gjeodezisë i nevojiten edhe 5 specialist gjeodetë duke plotësuar numrin e zyrtarëve të cilët janë në pension	Kërkesa nga ZKK tek Zyra e Burimeve Njerëzore	ZKK dhe Zyra e personelit	5 x 630 = 3150 në muaj	Q1-2025	Mungesa e aplikimeve specifike nga sektori i gjeodetëve
5	Resurset teknologjike	5.1	Kompjuterët e punës janë të vjetër	Duhet të shikohet mundësia të blihen kompjuterë të ri	Komuna e Prishtinës apo Agjencia Kadastrale e Kosovës	10 x 750 = 7500euro	Q3 - 2025	Mos funksionalizimi i vertikalizimit të Kadastrit për realizimin e kërkesës nga AKK
6	Kampanjat vetëdijësuese	6.1						
7	Dërgimi i disa SMS për palët	7.1	Të dërgohet SMS vetëm nga SIKTK dhe jo nga Intraneti	Organizimi i takimit në mes AKK dhe MAPL	AKK dhe MAPL	-	Q1-2025	Nuk parashihen rreziqe
8	Dorëzimi i lëndëve për ndarje-bashkim të njësive kadastrale dhe bartja e pronësisë për të njëjtat me një proces	8.1	Unifikimi i dorëzimit të lëndëve	Riorganizimi i punës në mes të sektorëve	ZKK	-	Q3-2024	Nuk parashihen rreziqe
9	ZKK-ja lëshon vendime vetëm në gjuhën shqipe	9.1	ZKK duhet të përkthej vendimet në bazë të gjuhës në të cilën është plotësuar formulari për aplikim	Të përkthehen vendimet në bazë të gjuhës zyrtare në të cilën është plotësuar formulari si dhe të publikohen njoftime me karakter të përgjithshëm në dy gjuhët zyrtare	Zyra e përkthimit e Komunës së Prishtinës	Nuk ka	Q3-2024	Nuk ka

## BARAZIA GJINORE DHE PËRFSHIRJA SOCIALE

Nr.	TË GJETURAT	REKOMANDIMET	VEPRIMET QË DUHET TË NDËRMERREN	AUTORITETI PËRGJEGJËS	NDIKIMET BUXHETORE (EUR)	AFATET KOHORE	RREZIQET DHE SFIDAT
1	<p><b>Të shqyrtohen masa të tjera afirmative për të rritur regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve. Udhëzimi Administrativ (QKR) 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pasurisë së përbashkët të paluajtshme në emër të të dy bashkëshortëve, i ndryshuar dhe plotësuar me UA (KKR) 04/2017, është derivat i masave të përkohshme afirmative të përcaktuara me Ligjin për Barazinë Gjinore.</b></p>	<p>Zyrtarët komunalë të organizojnë fushata vetëdijësuese për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve, me fokus për komunitetin Romë, Ashkali dhe Egjiptian. Agjencia për Barazi Gjinore ta bëjë të përhershme masën afirmative dhe ta zgjeroj edhe te nënat vetushqyese (grupet ma të cënueshme), etj; Të thjeshtëzohen procedurat që lidhen me regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve në të gjitha institucionet.</p>	<p>Organizimi i takimeve informuese, tryezave, fushatave vetëdijësuese, përfshirë edhe ato mediale me gra, burra, vajza e djem për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve. Të organizohet fushatë informuese në rrjete sociale dhe në Prishtina online për sensibilizim për të drejtat e grave. Agjencia për Barazi Gjinore të konsultohet me Agjencinë Kadastrale, komunat dhe OJQ-të që të zgjerojnë masën afirmative (nënat vetushqyese, gratë e veja, gratë në gjendje të cënueshme shëndetësore), dhe të bëjnë të përhershme masën afirmative. Të organizohen takime me noterët dhe AKK, për të të bërë ndryshime të nevojshme ligjore për thjeshtëzimin e procedurave për regjistrimin e pronës në emër të dy bashkëshortëve.</p>	<p>Kabineti i Kreytarit - Zyra për Komunitete dhe Kthim, Zyra për Barazi Gjinore, Qendra për Shërbime me Qytetarë</p>	<p>10,000 Euro</p>	<p>Fushatat të realizohen në baza 3 mujore, duke filluar nga Qershori 2024.</p>	<p>Mungesa e buxhetit, mungesa e stafit të Komunës</p>
2	<p><b>Duhet të krijohen masa dhe të ndërmiren veprime të veçanta për mbështetjen e grave, për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në nivel komunal, me qëllim të fuqizimit social dhe ekonomik.</b></p>	<p>Krijimi i një fondi komunal të përhershëm për t'u ndihmuar grave në biznes, e posaçërisht grave që fillojnë biznese të reja; Të krijohen mundësi për grante të vogla për blerje të paisjeve prodhuese dhe përpunuese; Në fusha të ndryshme të veprimtarisë ekonomike, përfshirë edhe në fushën e bujqësisë; subvencionimin me bagëti apo paisje në bujqësi; Të krijohet qendra grumbulluese për produktet bujqesore në Komunën e Prishtinës; Të shikohen mundësitë e prioritizimit (gjatë poentimit) të aplikantëve të cilët e kanë të regjistruar pronën në emër të dy bashkëshortëve, nënat vetushqyese, gjatë ndarjes së granteve dhe subvencioneve në fusha të ndryshme në komunë.</p>	<p>Planifikimi i hershëm i buxhetit në baza vjetore nga Drejtoria e Financave, mbi parimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor; Të zbatohet LBGJ dhe masat e veçanta në implementimin e ndarjes së subvencioneve në komunë. Të thjeshtëzohen procedurat dhe dokumentacionet e nevojshme për aplikim për subvencione. Të organizohen sesionet informuese për plotësimin e dokumentacionit (psh përgatitja e biznes planit dhe dokumenteve përcjellëse). Të bëhet monitorimi nga komisioni komunal (të themelohet komisioni) i vazhdueshëm i përfituesve në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria e projektit.</p>	<p>DF, DSHP, Drejtoria për Zhvillim Rural dhe drejtoritë përkatëse për thirrje për aplikim për subvencione.</p>	<p>Të diskutohet me secilën drejtori vec e vec për shumën e planifikuar për ndarje të graneteve dhe subvencioneve. Fondi i përhershëm për zhvillimin ekonomik komunal të ketë një rritje eksponenciale që do të përcaktohet në bashkëpunim me DF dhe drejtoritë përkatëse.</p>	<p>Ky veprim të përfshihet në planifikim buxhetor të vitit 2025, nga secila drejtori që planifikon përkrahje për start up për gratë dhe grupet tjera të marginalizume.</p>	<p>Mungesa e vullnetit politik, mungesa e koordinimit, mungesa e ndarjes së duhur buxhetore.</p>

3	<b>Ngritja e vetëdijes për qasjen e grave në trashëgimi.</b>	Informata rreth legjisllacionit në fuqi për gratë dhe grupet tjera të cënueshme. Ngritja e vetëdijes së burrave për të drejtat pronësore të grave. Sipas ligjit në fuqi, të zbatohen procedurat te noteri sa i përket marrjes së deklaratës në proceset e trashëgimisë, dhe shitblerjeve në mënyrë që gruas ti sigurohet qasja e drejtë në pronë dhe trashëgimi.	Të sigurohen resurse të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për zyrtarët e barazisë gjinore dhe zyrtarët tjerë komunalë që të ndërrmarin fushata vetëdijësuese, me theks te veçante në viset rurale dhe vendbanimet e komuniteteve. Të organizohet fushatë informuese në rrjete sociale dhe në Prishtina online për senzibilizim për të drejtat e grave në trashëgimi. Organizimi i fushatës vetëdijësuese: Tryeze diskutimi me akterë të ndryshëm, -Vendosja e posterëve me mesazhe senzibilizuese, faqe te komunës, rrjete sociale etj. -Organizimi i takimeve informuese, përfshirë fokus grupet me qytetarët ne qytet dhe vende rurale përmes përfaqësueseve të këshillave lokale. Trajnimi i vazhdueshëm me noterë për implementimin e Ligjit për Procedurën Jo-kontestimore.	Kabineti i Kryetarit - Zyra për Komunitete dhe Kthim, Zyra për Barazi Gjinore, Drejtoria e Administratës - Qendra për Shërbime me Qytetarë, Këshillat Lokal.	7,000 Euro	Fushatat të realizohen në baza 3 mujore, duke filluar nga Qershori 2024.	Mungesa e buxhetit, mungesa e stafit te Komunës, mungesa e pjesëmarrjes së duhur qytetare.
4	<b>Të ngritet qasja e personave me nevoja te veçanta në shërbimet komunale që lidhen me pronë e kadastër.</b>	Të sigurohet qasja për personat me karrocë në objekt të komunës. Të sigurohet qasja për persona me të pamur të dëmtuar dhe me probleme me dëgjim. Të rifunksionalizohen komitetet për persona me nevoja të veçanta. Të ngritet vetëdija për rëndësinë e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve dhe proceseve të trashëgimisë për këtë kategori.	Të sigurohet qasja me pjerrinë për persona në karrocë. Të sigurohet interpreti i gjuhës së shenjave dhe qasja në alfabetin e Brajlit për persona me te pamur dhe me dëgjim të dëmtuar.	Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Financave	Të bëhet diskutimi me drejtoritë përkatëse që të bëhet vlerësimi i realizimit të këtyre projekteve.	Ky veprim të përfshihet në planifikim buxhetor të vitit 2025.	Mungesa e vullnetit të drejtorive përkatëse, mungesa e planifikimeve adekuate për realizim.
5	<b>Të lirohen nga pagesa komunale lidhur me shërbimet kadastrale të gjitha palët që pronën e kanë të regjistruar në emër të dy bashkëshortëve ose në emër të gruas.</b>	Vendimi nga Kryetari i Komunës në bashkëpunim me drejtorinë përkatëse.	Të përgatitet propozimi për Kryetarin nga drejtoria përkatëse për lirimin nga pagesat komunale lidhur me shërbimet kadastrale.	Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Pronë dhe Kadastër, Drejtoria e Financave	Të bëhet diskutimi me drejtoritë përkatëse që të bëhet vlerësimi buxhetor për këtë aktivitet.	Ky veprim të përfshihet në planifikim buxhetor të vitit 2025.	Zvogëlimin e të ardhurave komunale nga këto shërbime. Të vërtetohet ligjshmëria e këtij vendimi me MAPL, MF dhe AKK.